



British Embassy
Tirana



IOM - OIM

UDHËZUES

PËR MIGRACIONIN E RREGULLT DHE PARANDALIMIN E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE



1. HYRJE	3
2. MUNDËSITË E MIGRACIONIT DHE RREZIQET	4
3. PASOJAT E MIGRACIONIT TË PARREGULLT	5
4. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E MIGRANTËVE	10
5. DOKUMENTAT E UDHËTIMIT PËR JASHTË SHETETI	12
7. LLOJET E VIZAVE	13
8. AMBASADAT DHE KONSULLATAT E HUAJA NË SHQIPËRI	15

HYRJE

IOM - Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, është krijuar në vitin 1951 si një organizatë ndërqeveritare në ndihmë të migrantëve të Evropës. Sot kjo organizatë ka zgjeruar fushën e aktiviteteve lidhur me menaxhimin e migracionit në mbarë botën dhe numëron 118 vende anëtare. Shqipëria është anëtarësuar në këtë organizatë që në vitin 1993.

Pas një gjysmë shekulli përvoja në terren, IOM është shndërruar në një organizatë kryesore në botë që punon për çështjen e migrantëve dhe mbështet qeveritë që të ofrojnë zgjidhje humane sfidave të migracionit.

IOM në Shqipëri ndihmon në forcimin e kapaciteteve institucionale për hartimin e politikave migratore. Gjithashtu IOM ofron informacion dhe asistencë lidhur me riintegrimin e migrantëve, si dhe parandalimin e trafikimit nëpërmjet aktiviteteve edukative. Në bashkëpunim me qeverinë Shqiptare, IOM ka hartuar "Strategjinë Kombëtare për Migracionin dhe Planin Kombëtar të Veprimit" në mbështje të menaxhimit të migracionit për integrimin e Shqipërisë në Evropë.

Projekti për nxitjen e migracionit të rregullt dhe parandalimin e trafikimit, financohet nga Ambasada Britanike dhe zbatohet nga IOM. Objektivi kryesor është krijimi i mekanizmave të reja të informimit lidhur me procedurat, legjislacionin dhe mënyrave të rregullta të migrimit nga-dhe nëpërmjet Shqipërisë dhe të nxisë migrimin e rregullt, parandalimin e trafikimit, që të reduktohen format e migrimit të parregullt, trafikimit dhe kontrabandimit të qenieve njerëzore. Shtrirja e projektit është në qarqet e Tiranës, Shkodrës, Durrësit, Vlorës, Peshkopisë dhe Kukësit, të konsideruara si zonat më të prekura nga fenomeni i migrimit të parregullt.

MUNDËSITË E MIGRACIONIT

Pa dyshim, migracioni ofron mundësi të shumta për të punuar, studiuar, për t'u bashkuar me familjen jashtë, si dhe për të vizituar vende të ndryshme. Migracioni i rregullt është një zgjedhje dhe nëse respektohen rregullat e vendeve pritëse është një mundësi për realizimin e qëllimit tuaj. Migracioni është një mundësi për zhvillim si për individin, ashtu dhe për shoqërinë, në vendet pritëse dhe të origjinës.

Përpjekjet e Shqipërisë për të hyrë në familjen e madhe evropiane, shoqërohen dhe me hapa konkretë për menaxhimin e migracionit. I tillë është nënshkrimi i Marrëveshjes së Ripranimit për rikthimin e shtetasve shqiptarë dhe të huaj, të cilët nuk plotësojnë kushtet për hyrje ose qëndrim të rregullt në vendet e Bashkimit Evropian. Kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi më 1 Maj 2006. Qeveria Shqiptare po bashkëpunon dhe me qeveritë e vendeve fqinje në luftën kundër trafikimit, kontrabandës dhe krimin të organizuar, duke forcuar kontrollin e kufirit.

Në këtë kontekst, nëse vendosni të migroni, duhet të informoheni mbi rrugët e rregullta të migrimit për në vendin ku do shkoni, për dokumentat që duhet të paraqisni për vizë dhe kushtet që duhet të plotësoni për riintegrim.

PASOJAT E MIGRACIONIT TË PARREGULLT

Migrantët që jetojnë dhe punojnë jashtë pa dokumentat e duhura njihen si emigrantë të parregullt. Migrantët e parregullt janë më të ekspozuar ndaj rrezikut të trafikimit dhe shfrytëzimit.

Duke qenë pa dokumenta, mund të mos keni të drejtë të përfitoni të drejtën për asistencë, shërbim mjekësor, arsimim. Shëndeti juaj mund të jetë në rrezik.

Në kuadër të hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Ripranimit me vendet e BE-së, migrantët e parregullt, mund të jenë objekt i kthimeve.

Pra, është e qartë se të udhëtosh me dokumentat e duhura është mënyra më e mirë për të evituar problemet. Është e domosdoshme të udhëtoni me dokumenta të rregullta! Duhet të dini se nëse migroni pa dokumenta ose me dokumenta fallco do të ndesheni me vështirësi.

TRAFIKIMI

Sipas Protokollit të OKB-së, Trafikimi i Qenieve Njerëzore "nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose mbajtjen e personave me anë të kërcënimit, ose përdorimit të forcës, apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, pandershmërisë, të abuzimit me pushtetin ose me pozitën vulnerabël apo të dhënies ose marrjes së pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi për të

kontrolluar një tjetër, me qëllim shfrytëzimin. Shfrytëzimi duhet të përfshijë, së paku shfrytëzimin për prostitucion të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën apo shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktika të ngjashme me të, robërinë ose heqjen e organeve”.

MEGJITHËSE NJERËZIT TRAFIKOHEN PËR SHFRYTËZIM SEKSUAL, VIKTIMAT TRAFIKOHEN DHE PËR ARSYE TË TJERA, PËRFSHI PUNËN E DETYRUAR (P.SH. NË FABRIKA OSE BUJQËSI), TRANSPLANT ORGANESH, SHËRBYM SHTËPIAK OSE PËR TË LUFTUAR NË KONFLIKTE TË ARMATOSURA.

MIGRACIONI I PARREGULLT ËSHTË NJË NGA SHKAQET E TRAFIKIMIT: pasojat për viktimat mund të jenë të ndryshme si shkelje e të drejtave të njeriut, dhunë, kërcënim, përdhunim, pamundësi për të kërkuar ndihmë dhe asistencë (për shkak të kontrollit të vazhdueshëm). Edhe kur viktimat kanë mundur t'u ikin tutorëve, shpesh janë riviktimizuar nga autoritete të ndryshme, p.sh. në rastet e deportimit për shkak të statusit të tyre të parregullt. Ata kanë patur dhe plagë të rënda fizike dhe psikologjike, si pasojë e traumave dhe keqtrajttimeve të shumta, të cilat reflektohen në mirëqenien e tyre. Frika për t'u mospranuar nga familja, shoqëria mund t'i shoqërojë ata ngado. Viktimat shpesh ndiejnë turp për atë që kanë qenë të detyruara të bëjnë dhe nuk duan që familja apo komuniteti të mësojë për to.

**TRAFIKIMI EKZISTON ENDE!
KËRKONI INFORMACION NË TË GJITHA BURIMET
E MUNDSHME, PËR T'U SIGURUAR QË PO BËNI
ZGJEDHJEN MË TË SIGURTË PËR TË MIGRUAR!**

KONTRABANDA

Kontrabanda është kalim i paligjshëm i kufirit, me dokumenta fallco ose të parregullta, me dëshirën e personit dhe përbën krim kundër shtetit.

Trafikimi dhe kontrabanda kanë ngjashmëri sepse janë biznese fitimprurëse që përfshijnë qeniet njerëzore në rrjete kriminale që veprojnë kundër ligjeve në fuqi.

Në rast se ndesheni me eksperiencën të trafikimit, mos hezitoni të kontaktoni zyrën e IOM, shërbimet shtetërore, autoritete të zbatimit të ligjit, OJF, Organizata Ndërkombëtare, individë etj. Në qendra pritëse ofrohet akomodim dhe strehim, ndihmë psiko-sociale, ndihmë mjekësore dhe ligjore si dhe paketa të plota integruese.

Nga viti 2000, Misioni i IOM-it në Shqipëri nëpërmjet programeve të Kthim-Riintegrit, ka asistuar 584 viktima trafiki, 332 prej të cilave janë shqiptarë.

MIGRANTËT E PARREGULLT MUND TË NDESHEN GJITHASHTU ME PROBLEME TË TJERA, SI:

- Mund t'ju ndalohet hyrja në shtetin ku do të shkoni, nëse punonjësi i kufirit gjykon se nuk i plotësoni kushtet për të kaluar kufirin.
- Megjithatë, nëse arrini të kaloni kufirin, mund të rrezikoni të ktheheni, në rast se nuk jeni të paisur me leje pune të rregullt (p.sh. nëse jeni me vizë turistike, ose nëse ju ka skaduar viza). Nëse leja juaj e punës i përket dikujt tjetër mund të rrezikoni të futeni në burg ose të deportoheni. Kur punoni me leje pune jo të rregullt, mund të shfrytëzoheni ose të keqtrajtoheni nga punëdhënësi. Mund të paguheni më pak dhe t'ju mohohet e drejta për pushim dhe sigurimet shoqërore.
- Si pasojë e parregullsive, mund t'ju ndalohet hyrja në atë vend për një periudhë prej pesë apo më shumë vitesh.
- Në çdo rast duhet të keni kujdes nga sëmundja e HIV/AIDS, dhe të përdorni masa mbrojtëse. Parandalimi është mbrojtja më e mirë!

MBAJTJA NË BURG OSE DEPORTIMI

Kohët e fundit, është rritur numri i migrantëve të kthyer, si rezultat i statusit të tyre jo të rregullt, dokumentave false, përpjekjeve për të hyrë në një shtet tjetër pa vizë ose puna pa dokumenta përkatëse.

TË DREJTAT E MIGRANTËVE NË RAST ARRESTIMI, BURGIMI OSE DEPORTIMI

Megjithëse ligjet ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin lidhur me arrestimet, burgimet ose deportimet, në përgjithësi, të drejtat e migrantëve në këto kushte janë:

- E drejta për përkthyes, nëse nuk flisni gjuhën e vendit ku ndodheni.
- E drejta për të kontaktuar dhe kërkuar asistencë nga shërbimet konsullore të vendit nga vini.
- E drejta për të kontaktuar me familjen dhe avokatin tuaj.

MËSONI MË SHUME MBI MIGRACIONIN E RREGULLT DHE KUJDES NGA RREZIQET E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE!

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E MIGRANTËVE

TË DREJTAT

TË GJITHË MIGRANTËT, ME OSE PA DOKUMENTA KANË DISA TË DREJTA THEMELORE:

- Të drejtën për të marrë trajtim mjekësor në rast urgjence.
- E drejta për të kontaktuar me familjen dhe avokatin e tyre.

MIGRANTËT ME DOKUMENTA TË RREGULLTA KANË GJITHASHTU TË DREJTËN PËR:

- Sigurime shoqërore dhe asistencë mjekësore, arsimim, strehim, asistencë shoqërore.
- Të drejtën për punë 8 orëshe dhe leje vjetore.
- Të drejtën për të bërë pjesë në sindikata.
- Të drejtën për bashkim familjar.

DETYRIMET

Të respektojnë rregullat dhe ligjet e vendit pritës, rregullat e trafikut rrugor, udhëtimit, pajisjen me bileta autobuzi.

Mos merrni pako për persona të tjerë kur shkoni në një vend tjetër, sepse mund të përfshihen në trafik droge.

Respektoni traditat e vendit ku shkoni lidhur me përdorimin e alkoolit, duke ruajtur kështu dhe shëndetin tuaj.

Kur i jepni makinës, mos përdorni alkool dhe respektoni kufirin e shpejtësisë, duke evituar gjokat.

Migracioni nuk është vetëm një mundësi për një punë dhe pagë më të mirë, por është dhe një mundësi për të mësuar dhe përfituar nga kultura dhe traditat e vendit ku ndodheni.

PËRFITONI!



DOKUMENTAT E UDHËTIMIT

Për të udhëtuar jashtë shteti ju duhet një **PASAPORTË** brenda afatit të skadencës dhe një **VIZË** e vlefshme për periudhën e qëndrimit.

Nëse dëshironi të pajiseni me pasaportë të re, mund të aplikoni pranë komisariateve të policisë në zonën përkatëse, duke paraqitur një çertifikatë lindjeje dhe katër foto të kohëve të fundit, formularin që i shoqëron dhe pagesën.

NËSE UDHËTONI ME MAKINËN PERSONALE, PËRVEÇ PASAPORTËS JU NEVOJITET:

- **LEJA E QARKULLIMIT NDËRKOMBËTAR**
- **PATENTA NDËRKOMBËTARE PËR SHOFERIN**
- **SIGURACIONI I VLEFSHËM (KARTONI JESHIL)
PËR JASHTË SHTETI**
- **KUTIA E NDIHMËS SË SHPEJTË**
- **LLAMPA DHE SIGURESA REZERVË**

LLOJET E VIZAVE

Viza është një autorizim në pasaportën tuaj, që ju lejon të hyni në vendin ku dëshironi. Pasaporta juaj duhet të jetë e vlefshme për të paktën dhe 6 muaj të tjerë. Zakonisht mund të aplikoni në ambasadat ose konsullatat e përkatëse. Në disa raste, mund të pajiseni me vizë edhe në kufirin e vendit ku shkoni. Në rast se keni një pasaportë shërbimi, mund të hyni dhe pa vizë në disa shtete, ose duke njoftuar Ministrinë e Jashtme Shqiptare për të ndjekur procedurat.

Ju mund të aplikoni në ambasadat ose konsullatat e shtetit ku dëshironi të shkoni për vizë:

PËR PUNËSIM:

Informohuni mbi mundësitë e punësimit të rregullt në këto vende. Nëse ju ofrohet një kontratë për të punuar jashtë, përpuni ta konfirmoni atë dhe të kuptoni kushtet e punës. Kini parasysh se për të punuar jashtë, ju nevojitet një leje pune në vendin ku do punoni.

PËR STUDIME:

Kontakttoni Zyrat Konsullore të Ambasadave përkatëse, për të marrë informacion mbi mënyrat e aplikimit, për të fituar të drejtën e studimit apo bursë, duke kontaktuar universitetet dhe kolegje; flisni me shokët ose me ish-studentët.

PËR VIZITA TURISTIKE:

Mermi informacion mbi procedurat dhe dokumentat që duhet të paraqisni. Kontrolloni kush do paguajë për udhëtimin në rast se nuk paguani vetë dhe mos harroni që diçka mund të fshihet pas kësaj pagese.

BASHKIME FAMILJARE:

Informohuni mbi të drejtat tuaja si familjar dhe çfarë kushtesh duhet të plotësoni që të përfitoni bashkimin me pjesën tjetër të familjes që ndodhet në vendin pritës, sepse vende të ndryshme kanë legjislacione të ndryshme. Këshillohuni gjatë përgatitjes së dokumentacionit për këtë procedurë. Shpesh hasen probleme në përgatitjen e tij. Kjo bën që aplikimi të fillojë nga e para.

TRANZIT:

Këto janë viza afatshkurtëra gjatë udhëtimeve në destinacion.

Vizat me shumë hyrje ju lejojnë të hyni disa herë në vendin që ua ka dhënë këtë vizë.

Informohuni për dokumentacionin përkatës që duhet të paraqisni. Kujdes kushtet e vizave dhe plotësoni me korrektesë formularët. Rregullat e aplikimit mund të ndryshojnë nga njëri shtet në tjetrin.

AMBASADAT DHE KONSULLATA TË HUAJA NË SHQIPËRI

AUSTRI

Rr. "Frederik Shiroka", Nr.3,
Tel: 233157/233144; Fax: 233140
E-mail: tirana-ob@bmaa.gv.at

ARABIA SAUDITE

"Torre Drin", Kati 5,
Tel. 248306/7/7/8; Fax: 248306
E-mail: embsaudarab@albaniaonline.net

BRITANIA E MADHE

Rr. "Skënderbej", Nr.12,
Tel: 234973/5; Fax: 247697
E-mail: matilda.mucollari@fco.gov.uk

BULLGARI

Rr. "Skënderbej", Nr.12,
Tel: 232906/233155; Fax: 232272
E-mail: bgemb@icc.al.eu.org

ÇEKI

Rr. "Skënderbej", Nr.10,
Tel. 232117/234004; Fax: 232159
E-mail: tiranaczemb@albaniaonline

DANIMARKË

Rr. "Nikolla Tupe", Nr. 1,

Tel: 257422/3/4; Fax: 257420

E-mail: tiaamb@um.dk/ambadane@icc.al.eu.org

EGJIPT

Rr. "Skënderbej", Nr. 43,

Tel: 233022/247986; Fax: 232295

E-mail: egyemb@albaniaonline.net

FRANCË

Rr. "Skënderbej", Nr. 14,

Tel: 234054/234250; Fax: 234442

E-mail: ambftir@mail.adanet.com.al

GJERMANI

Rr."Skënderbej", Nr.8,

Tel: 274505/6/7/8; Fax: 233497

E-mail: german.embassy@icc.al.eu.org

GREQI

Rr. "Frederik Shiroka", No.3,

Tel: 223959/247897; Fax: 234140/235224

E-mail: gremb.tir@mfa.gr

HUNGARI

Rr. "Skënderbej", Nr. 16,

Tel: 234903/232238; Fax: 233211

E-mail: huembtia@interalb.net

ITALI

Rr. "Lekë Dukagjini", Nr. 2,

Tel: 275900/234045/6/7

255051/227406/250921

Mund të caktoni takim duke telefonuar në numrin:

0900 707 400

Fax: 250921

E-mail: segreteria@ambitalia-tirana.com

IRAN

Rr. "Mustafa Matohiti", Nr. 20,

Tel: 255038/227698; Fax: 230409

LIBI

Rr. "Arben Broci", nr.6,

Former UNICEF Villa

Tel: 379114; Fax: 379117

E-mail: amblibi@abissnet.com.al

ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË

Rr. "Lekë Dukagjini", Nr. 2,

Tel: 233036/230909; Fax: 232514

E-mail: makambas@albnet.net

HOLLANDË

Rr. "Asim Zeneli", Nr. 10,

Tel: 240826/8/240841; 240 839; Fax: 232723

E-mail: tir@minbuza.nl

NORVEGJI

Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Sky Tower,

Nr. 5, kati 5,

Tel: 256923; Fax: 221507

E-mail: embtia@mfa.no

POLONI

Rr. "Durrësi", Nr. 123,

Tel: 234190; Fax: 233247

E-mail: polemb@albaniaonline.net

TURQI

Rr. Kavajës, Nr. 31

Tel. 274588 ; Fax : 232719

E: mail: turkishembassy@albaniaonline.net

RUMANI

Rr. "Themistokli Gërmenji", Nr. 1,

Tel: 256071/2; Fax: 256072

E-mail: roemb@adanet.com.al

RUSI

Rr. "Asim Zeneli", Nr. 5,

Tel: 256040; Fax: 256046

E-mail: rusemb@icc.al.eu.org

KANADA (KONSULL NDERI)

Blv. "Zhan D'Ark", Techno-Project Tower, Nr. 2, Ap. 1,

Tel: 257274/5, Fax: 257273

Mob: 0682029364

E-mail: canadalb@canada.gov.al

KINË

Rr. "Skënderbej", Nr. 57,

Tel: 232385/232077; Fax: 233159

E-mail: chinaemb_al@mfa.gov.cn

KROACI

"Torre Drin",

Tel: 228390/256948; Fax: 230578

E-mail: croembassy@albaniaonline.net

REPUBLIKA ÇEKE

Rr. "Skënderbej", Nr. 10,

Tel: 232117/234004; Fax: 232159

E-mail: tiranaczemb@albaniaonline.com

RUMANI

Rr. "Themistokli Gërmenji", Nr.1,

Tel: 256071/2; Fax: 256072

E-mail: roemb@adanet.com.al

SERBI DHE MALI I ZI

Rr. "Skënderbej", Nr 8/3/2,

Tel: 232091; Fax: 232089

E-mail: ambatira@icc-al.org

SPANJË (KONSULL NDERI)

Rr. "Kajo Karafili", Pall. Bimbashi,

Fax: 224693

E-mail: skendervucini@hotmail.com

SH.B.A.

Rr. "Elbasani", Nr. 103,

Tel: 247285/6/7/8/9; Fax: 232222

SUEDI

Rr. "Qamil Guranjaku", Pall. 2,

Tel: 347524; Fax: 347525

E-mail: info@sweeden.gov.al

ZVICËR

Rr. Elbasanit, Nr. 81,

Tel: 234888; Fax: 234889

E-mail: vertretung@tir.rep.admin.ch

KONSULLATA NË QARQE

VLORË

Konsullata Italiane

Rr. Ismet Çakërri, Nr. 45

Tel: 033 25705, 033 25707

Fax: 033 25709

Homepage: www.consvalona.esteri.it

E-mail: consolato.valona@esteri.it

SHKODËR

Konsullata Italiane

L. Migjeni, Rr. "Don Bosko"

Tel: 022 48260

Fax: 022 48286

Homepage: www.consscutari.esteri.it

E-mail: consolato.scutari@esteri.it

Konsulli i Nderit të Austrisë

Z. Gjergj Leqejza

Tel: 022 47014

PËR MË TEPËR INFORMACION, KONTAKTONI:

ZYRËN E ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE PËR MIGRACION (IOM)

Rruga "Brigada e Tetë", Vila nr. 3, Tiranë

Tel: 355 4 257 836/7/271 629

Fax: +355 42 57835

E-mail: iomtirana@iomtirana.org.al

QENDRËN E SHËRBIMEVE PËR MIGRANTË (IOM-MS)

Tel & Fax: 355 4 271 628

OSE VIZITONI:

WWW.IOMTIRANA.ORG.AL

(*link*: Qendra Shërbimeve për Migrantë)

WWW.UK.AL

Në këtë faqe mund të gjeni një informacion të hollësishëm mbi lajmet, aktivitetet dhe shërbimet që ofron kjo ambasadë në Shqipëri në shqip dhe anglisht. Në seksionin "SHËRBIME" do të gjeni të dhëna të hollësishme për aplikime për vizë, përfshirë dhe formularët e aplikimit, shërbimet konsullore, pasaportat dhe këshilla për udhëtimin. Këtu mund të mësoni mbi mundësitë për studim në Britaninë e Madhe dhe mbi tregtinë me Britaninë e Madhe.

WWW.WORKINGINTHEUK.GOV.UK

Kjo faqe ju ofron informacion lidhur me mundësitë e emigracionit për punësim në Britaninë e Madhe, për shtetasit e huaj.

WWW.IND.HOMEOFFICE.GOV.UK

Kjo faqe ju ndihmon të mësoni mbi kontrollin e migracionit në Britaninë e Madhe dhe se cilat janë të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja kur aplikoni.



**MIGRACIONI
I RREGULLT
ËSHTË ZGJEDHJE
DHE MUNDËSI**



**MIGRACIONI
I RREGULLT
ËSHTË ZGJEDHJE
DHE MUNDËSI**